



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe nenve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr:

**VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES**

**Neni 1
Përbërja**

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarje të subvencioneve për projektet të OJQ-ve që veprojnë në Komunën e Lipjanit, në përbërje si vijon:

1. Bekim Zaskoku, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesues
2. Shaban Sylja, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtar
3. Arbnor Dulla, nga OJQ-të, anëtare
4. Laureta Terpeza, nga shoqëria civile në cilësinë e ekspertit, anëtare
5. Albulena Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtare
6. Bukuriye Zejnullahu-Jashari, Zyra e Kryetarit të Komunës, anëtare rezerv

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për ndarje të subvencioneve për OJQ-të që veprojnë në Komunën e Lipjanit, që kanë aplikuar sipas Thirrjes publike për aplikim Nr.1-453-50895 e datës 16.10.2020, konform dispozitave të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

INr. 453-56185

Lipjan, më 12.11.2020

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

